

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	"Të plasi tr*pi"/ Çfarë zbulojnë email-et e Ballukut për vilën në Green Coast
ADRESA	https://piranjat.al/aktualitet/te-plasi-trapi-fare-zbulojne-email-et-e-ballukut-per-vile-n-ne-green-c-i104798
BURIMI	piranjat.al
GJENDJA	edited

KOHA


KAPUR NGA NE	18 shtator 2026, 09:24:26 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	18 shtator 2026, 09:08:12 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	1850bc8aaf609a903bfad7558a54eab92b266c9f2edc64c0effc5be649d9e2
TEKSTI	47a4782202c30758cb8131d7b29994e84117d3af68a9ce7b1cb7a18fa0700212
PAMJA	04475f46ab2a1786be8ce40abb29fd6bd9b35e9aaba1a817ea21533facf1bad

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	dd33926cbab528f9ffca6fc9c3f852846f356756cb648c79b90e6b0d5c9fba99
E MËPARSHMJA	dc1aab488053ad95345db56f12001784f0737cf9ed96d09b953b0044563b4368
RRËNJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/dd33926cbab528f9ffca6fc9c3f852846f356756cb648c79b90e6b0d5c9fba99>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [EDITORIAL](#)
- [EMISIONE](#)
- [INVESTIGIME](#)
- [AKTUALITET](#)
- [SOCIALE](#)
- [POLITIKË](#)
- [KOSOVA](#)
- [BOTA](#)
- [SHOWBIZ](#)
- [LIFESTYLE](#)
- [SPORT](#)

[SYRI LIVE](#)



Flash:

shqiptarë, kërkohen nga drejtësia ja për çfarë shpreh

nga "Dardanët" njofton

mos mjaftonin trazirat politike të

surprizë: Tentova të qieia

me muzikantin Maxx Morando

Presidenti Begaj ministri i ri i

Brendshëm, Ervin Dema

policie te pakënaqur naa

Agasi kanë ankimuar në Apelin

pr

AKTUALITET

“Të plasi tr*pi”/ Çfarë zbulojnë email-et e Ballukut për vilën në Green Coast

Piranjat Përditësimi i fundit 18 Shtator 2026, 11:08



Vendimi i GJKKO-së për sekuestrimin e vilës në kompleksin “Green Coast” përmban një numër komunikimesh dhe emailësh që Prokuroria i ka administruar si pjesë të hetimit. Në to shfaqen komunikime për projektimin, ndryshimet në vilë, pishinën dhe punimet, por edhe mesazhe të tjera që lidhen me procedurën e tenderimit të Unazës së Jashtme të Tiranës. Lapsi.al e disponon të plotë këtë vendim.

Një pjesë e komunikimeve lidhen drejtpërdrejt me adresën elektronike të Belinda Ballukut dhe me kërkesat që, sipas vendimit, ajo kishte bërë për ndryshimet në projektin e vilës 188 në Green Coast.

“Kemi ide edhe nëse një ditë vendos ta japësh me qera”

Në një email të datës 14 shtator 2020, të dërguar nga Alban Efthimi në adresën , në subjektin “PLANE REV 01”, përshkruhen një sërë propozimesh për vilën.

Në mesazh përmenden ndryshime të mundshme në organizimin e hapësirave, shkallët, parkimin, pishinën dhe tarracën. Ndër të tjera shkruhet se:

“Kemi ide edhe nëse një ditë vendos ta japësh me qera.”

Në të njëjtin komunikim përshkruhet edhe mundësia e vendosjes së një tavoline ngrënieje pranë pishinës, përdorimi i tarracës dhe ndryshime në dhomat e shtëpisë.

Katër ditë më vonë, më 18 shtator 2020, një tjetër email i dërgohet të njëjtës adresë elektronike. Bashkëngjitur, sipas vendimit, ishte dokumenti me emërtimin “200918_VILAT BINJAKE 188_PALASË.pdf”, ku përshiheshin planimetria dhe projekte të sipërfaqeve të dy vilave.

Ndryshimet në projekt: “Sipas kërkesave të klientit”

Në një tjetër komunikim të datës 1 tetor 2020, nga studioja projektuese dërgohet planimetria e vilës 188, ku thuhet se janë reflektuar ndryshimet sipas kërkesave të klientit.

Në emailin pasues përmendet se në projekt janë reflektuar kërkesat e klientit dhe se, pasi të vendoset një dakordësi e re, do të vijojë puna për elementet e projektit.

sh.p.k.)

- Në datën 01.10.2021, në orën 10:47, shtetasja Belinda Balluku i dërgon shtetasit Evis Berberi mesazhin *"Behu gati per unazat te henen ne mengjes"*. Në orën 10:48, Evis Berberi: *"Njofsimin? Apo inspektim"*. Në orën 10:48, Belinda Balluku: *"Njofsimin more"*. Në orën 10:48-10:49, Evis Berberi: *"Jo sot ne darke? Ska ndryshim?"*. Në orën 10:49, Belinda Balluku: *"A do ti nxjerresh ne darke sot? Shume mire Por do te te them"*. Në orën 10:50, Evis Berberi: *"Ok po pres po me duhen 3 ore kohe nese ka ndryshime"*. Në orën 10:52, Belinda Balluku: *"Asnje ndryshim"*. Në orën 10:52, Evis Berberi: *"Ok"*. Në orën 10:52, Belinda Balluku: *"Thjeshte te bej kengen Por jam ne kukes"*. ... Në orën 16:12, Evis Berberi: *"Unazat nga ora 10 e darkes"*. Në orën 21:18, Evis Berberi: *"Te vazhdojme apo te presim per neser"*. Në orën 21:31-21:32, Belinda Balluku: *"Jo , te mërkurën Ikni shijoni fundjavën Merruni me pune serioze Ke nje plehre aty qe flet"*. Në orën 21:33, Evis Berberi: *"Cfare ka dale Ok te merkuren"*.
- Në datën 05.10.2021, në orën 12:50, shtetasi Evis Berberi i dërgon shtetases Belinda Balluku mesazhin *"Ka ardhur Stop dhe kerkon informacion per proceduren e prokurimit Loti 1 (Shqiponja). I thame bej kerkese me shkrim te marresh pergjigje e beri, kerkojne te dine nese eshte shpallur fituesi, ka pasur ankesa, nese nuk eshte shpallur pse jo? Ben dhe nje kronike jashte dhe iken"*. Në orën 12:50-12:51, Belinda Balluku: *"Te plasi trapi Bej punen dhe zbato ligjin Kur te te vi ty afati I pergjigjes, do kesh mbaruar me procedurat Neser publikoji te gjitha ne darke"*. Në orën 12:51, Evis Berberi: *"Ok"*. (Në lidhje me komunikimin e mësipërm, nga hetimi rezulton se, të nesërmen, në datën 06.10.2021, në orën 20:03, në sistemin elektronik të prokurimit është përfunduar vlerësimi i ofertave të operatorëve ekonomikë nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, për procedurën e prokurimit me objekt *"Ndërtim i Unazës së Jashtme Tiranë, Loti 4"*).

11

Vila ndryshonte gjatë punimeve

Komunikimet e administruara në dosje vijojnë edhe gjatë vitit 2021 dhe 2022, ku diskutohen ndryshime të tjera në projekt.

Në një prej tyre përmendet kërkesa për të ndryshuar muret, për të zgjeruar hapësirat dhe për të reflektuar kërkesat e klientit në planimetri. Një email tjetër i referohet drejtpërdrejt aprovimit të klientit për ndryshimin e korridorit të vilës 188, duke shkruar se Olsi Efthimi kishte kërkuar që korridori të ngushtohej për t'u krijuar më shumë sipërfaqe dhomave.

Në dosje përfshihen gjithashtu komunikime për pishinën, ku studioja projektuese dërgon materiale për "jacuzzin dhe pishinën, VILA 188", si dhe materiale për prishjen e mureve dhe ndryshimet e tjera të vilës.

Një element tjetër i evidentuar nga hetimi lidhet me financimin e punimeve.

Sipas të dhënave të përfshira në vendim, në sistemin financiar të shoqërisë "SuperPool Kimya", në rubrikën e klientit rezultonte "PISHINA ARBER ABAZI (DHERM + BELINDA)".

Sipas dokumentacionit të përshkruar nga gjykata, për punimet e pishinës rezultonin dy fatura, njëra prej 15 mijë eurosh me përshkrimin "Shtrim linja tubash, faza 1 pishinë" dhe tjetra prej 10 mijë eurosh me përshkrimin "Parapregim". Totali ishte 25 mijë euro.

Mesazhet për tenderin e Unazës

Përveç komunikimeve që lidhen me vilën, vendimi përmban edhe komunikime të administruara nga telefoni i Evis Berberit dhe komunikime mes tij dhe Miranda Shkurrit.

Më 11 gusht 2021, në ditën e hapjes së ofertave për procedurën e tenderit, Miranda Shkurri i dërgon Berberit një mesazh ku shkruan:

"Hapen ofertat e 15 shtatorit 2021?"

Më pas, në komunikime të tjera, diskutohen ofertat dhe operatorët ekonomikë pjesëmarrës. Në një prej tyre, Miranda Shkurri i dërgon Berberit fotografi ku paraqiten emrat e operatorëve dhe vlerat e ofertave.

Një nga mesazhet e tjera të cituara në vendim është ai i 1 tetorit 2021, kur Balluku i shkruan Evis Berberit:

"Behu gati per unazat te henen ne mengjes."

Në vijim të këtij komunikimi, sipas vendimit, Balluku i shkruan Berberit edhe për një takim dhe për dokumentacionin që lidhet me procedurën.

Po në këtë periudhë, më 5 tetor 2021, Berberi i dërgon Ballukut një mesazh ku i thotë se kishte ardhur një i emisionit "Stop" dhe kërkonte informacion për procedurën e prokurimit për Lotin 1. Në përgjigje, sipas vendimit, Balluku shkruan:

"Te plasi trapi bej punen dhe zbato ligjin Kur te ve ty afati i Pergjigjes."

Vendimi thotë se më 6 tetor 2021, procedura për objektin "Ndërtimi i Unazës së Jashtme Tiranë, Loti 4" rezultoi e përfunduar në sistemin elektronik të prokurimit.

Çfarë rëndësie u jep GJKKO këtyre komunikimeve?

Komunikimet janë pjesë e materialeve që gjykata ka marrë në shqyrtim për të vlerësuar kërkesën e SPAK për sekuestrimin e vilës. Në vendim, Prokuroria pretendon se vila dhe punimet e kryera në të lidhen me përfitime të dyshuara të parregullta nga procedura e tenderimit të Unazës së Jashtme, ndërsa gjykata ka vlerësuar se në këtë fazë ekzistojnë të dhëna që justifikojnë masën e sekuestrimit preventiv./Lapsi.al

Artikuj te sugjeruar

Përfshihet nga flakët automjeti në një parkim nëntokësor në Fier, banorët në panik

Një automjet tip “Mercedes-Benz.” është përfshirë nga flakët paraditen e sotme në hyrjen e parkimit nëntok...

AKTUALITET 18 Shtator11:00

Iu plagos kolegu, avokatët në Durrës bojkotojnë për dy orë seancat gjyqësore

Avokatët kanë pezulluar aktivitetin në shenjë proteste pas plagosjes me armë të kolegut të tyre, Elton Shllaku. Ata kë...

AKTUALITET 18 Shtator09:52

U ndaluan gjatë tensioneve para Parlamentit, lirohen 25 protestuesit

25 protestuesit, që u shoqëruan një ditë më parë në komisariat gjatë tensioneve në tubimin e djeshëm pë...

AKTUALITET 18 Shtator09:37

Bllokimi i pagave të magjistratëve/ Drejtoresha e Thesarit, Elmira Peto merret në pyetje nga SPAK

SPAK ka marrë në pyetje drejtoreshën e Thesarit, Elmira Peto, në lidhje me bllokimin e pagave të magjistratëve. Elmira...

Nga Xhuljan Ferzaj AKTUALITET 18 Shtator09:10

VIDEO/ Denoncimi i banorit nga Frakulla e Madhe: Mbeturinat hidhen përpara shtëpive

Një qytetar nga fshati Frakull e Madhe, në rrethin e Fierit, ka dërguar një denoncim në redaksinë e Piranjat News, ku ankohet p&...

AKTUALITET 18 Shtator08:28

Këmbimi valutor/ Me sa blihen e shiten dollari dhe euro, çfarë ndodh me monedhat e tjera

Në tregun e këmbimit valutor shqiptar, një dollar amerikan do të blihet sot me 79.4 lekë dhe do shitet me 80.4 lekë. Ndërk...

AKTUALITET 18 Shtator08:25

Nga Lazarati te Kanadaja: Si po ndryshon trafikimi i kanabisit në Shqipëri

Një dekadë më parë, Europol e konsideronte Shqipërinë një prej burimeve kryesore të kanabisit që trafikohej drejt...

AKTUALITET 18 Shtator07:46

Historiania Enriketa Papa: dokumentet tregojnë se filmat në Shqipëri nisën para inagurimit të Kinostudios

Pedagogia e njohur e historisë, Enriketa Papa, ka sjellë në vëmendje një fakt pak të njohur mbi historinë e kinematografisë&...

AKTUALITET 18 Shtator07:33

Moti sot/ Kthjellime dhe vranësira të pakta, reshje të izoluara në mesditë

Sot vendi ynë do të ndikohet nga kushte atmosferike të qëndrueshme. Moti parashikohet i kthjellët si dhe vranësira të pakt...

AKTUALITET 18 Shtator07:16

“Taksë e fshehtë” mbi naftën për rezervën e sigurisë, do të rritet çmimi, e pranon dhe qeveria

Qeveria propozoi të krijojë rezervën strategjike të naftës në pronësi të shtetit shqiptar, por një pjesë e k...

ME TE VIZITUARAT

AKTUALITET 17 Shtator

Këta janë tre të rinjtë nga Fieri që humbën jetë...

Një aksident tragjik ka ndodhur në orët e para të mëngjesit në lagjen Glifadha të Athinës, ku kanë humbur jetë...

POLITIKE 17 Shtator

Tensionet te ministria e Brendshme, shoqërohet ...

Vijojnë tensionet para Ministrisë së Brendshme. Një grup protestuesit kanë hedhur letra higjienike në drejtim të policisë&e...

BOTA 17 Shtator

I veshur si grua, 33-vjeçari ‘tradhtohet’ dhe a...

Ai ndodhej is bërë dëlë, por një tregues i tradhtoi Jordan Lopa dhe Silva. 22 vjeç, i kthyer me shpirt si grua, duke vëndosur një p...

...si përmbajtje të ndryshme, por një numër i caktuar, shtuar kështu në total, 25 të njëjtit, si dhe numërat e gruas dhe të mosha të tyre, ...

INVESTIGIME 17 Shtator17:59


[Tensionet te Kuvendi, shoqërohen në polici të paktën 25 protestues](#)

Të paktën 25 persona janë shoqëruar nga policia pas tensioneve të regjistruara gjatë protestës së zhvilluar sot pranë eum...

video



E premtë | ? 20:45 | Syri TV





Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.